

# “ELFIDA” SHPK –STATUTI

## KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Ne Tirane me 22 Prill 2024 (Dymjje e njezete e kater )

### NENI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ELFIDA” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.3 Në rast transferimi të veprimitarisë tregtare mund të ruhet i njëjtë emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

### NENI 2 SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Yzberisht, zona kadastrale nr. 3866, vol.167, fq 222, pasuria nr.215/88/ND-N9 “Yzberisht, Tirane” me sipërfaqe 111m2.
- 2.2 Ortaket e Shoqerise mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në

bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

- Bar Kafe.
- 4.2** Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve.
- 4.3** Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.

## **KREU II** **KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI**

### **NENI 5** **KAPITALI I SHOQËRISË**

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është 10 000 ( dhjete mijë ) Lekë, i përbërë nga 1 (nje) kuote me vlerën 10 000 (dhjete emije) Lekë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit, i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Dursun Deniz**, shtetas Turk, lindur në Turqi, më 14 Janar 1981, mbajtës i Passport me Nr. U28799494, banues në adresën: Rruga Budi kompleksi Ana, kat 5, apartamenti nr 455, Tirane, Shqipëri, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

### **NENI 6** **TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET**

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Ortaket e Shoqerise, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 7** **BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT**



- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

**KREU III  
NDRYSHIMI I KAPITALIT**

**NENI 8**

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Ortakeve te Shoqerise mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Ortakeve apo Administratoreve të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 9  
ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 9.1** Ortaket e Shoqerise, mund të vendosin që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortaket e Shoqerise, me vendim të kene miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortaket e Shoqerise caktojne një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, ortaket e shoqërisë, me një vendim tjetër, përcaktojne mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortaket e shoqerise, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë



Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

**KREU IV  
ORGANIZIMI I SHOQËRISË  
NENI 10  
STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE**

**10.1** Shoqëria tregtare "ELFIDA" SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :

- Ortaket e shoqerise si organi vendimmarrës për shoqërinë;
- Administratoret

**NENI 11  
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS**

**11.1** Ortaket e shoqerise, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;



- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.2** Ortaket e shoqersie marrin vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrat dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të ortakeve te shoqerise. Ortaket e shoqerise, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrat të mbledhjeve.
- 11.4** Nga ana e Ortakeve te shoqerise merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statuti.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **NENI 12**

### **MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS**

- 12.1** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakeve thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.



- 12.2** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nga kryesisht nga ortaket e shoqerise, administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së parashikuar në mbledhjen e Ortakeve. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**KREU V  
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**


**NENI 13  
ORTAKET E SHOQERISE**

- 13.1** Ortaku i vetem i Shoqërisë eshte:

- **Z.Dursun Deniz**, shtetas Turk, lindur në Turqi, më 14 Janar 1981, mbajtës i Passport me Nr. U28799494, banues në adresën: Rruga Rruga Budi kompleksi Ana, katë 5, apartamenti nr 455, Tirane, Shqipëri.

**NENI 14  
VENDIMET E ORTAKEVE E SHOQERISE**

- 14.1** Ortaket e shoqerise, në përputhje me legjislacionin shqiptar marrin vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakeve te shoqerise.
- 14.2** Vendimet e Ortakeve te shoqerise duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.



**NENI 15  
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**15.1** Të drejtat dhe detyrat e ortakeve te shoqerise janë:

- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakeve;
- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Të informohet mbi përbajtjen e raportit te administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
- Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

**NENI 16  
FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortaket e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU VI  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 17  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (nje) Administrator te cili emërohen nga ortaket e shoqerise për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratore te shoqerise emërohen:

**Z.Besim Subashi**, shtetas shqiptar, lindur ne Kruje, me 20 Prill 1987, mbajtes i leternjoftimit nr I70420010K, banues në adresën: Rruga "Aleksandri i Madh" njesia nr 6, pallati Grand 2, Tirane, Shqipëri, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

- Mandati i administratorit do te jete 5 – vjet.
- Data e fillimit te mandatit te admimistratorit 22.04.2024 deri me 21.04.2029



- 17.2** Në zbatim të këtij nenit, administratoret e shoqerise përfaqësojnë Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve te shoqerise apo organeve të tjera të Shoqërisë.

## **NENI 18**

### **TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT**

- 18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakeve te shoqerise për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) raportojë përpara Ortakeve te shoqerise në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



**NENI 19  
PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT**

- 19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 20  
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 20.1** Ortaket e shoqerise përcaktojne shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

**KREU VII  
KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 21  
KONTROLLI KONTABËL**


- 21.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi. Ortaket e shoqerise do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.
- 21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 22  
VITI FINANCIAR**

- 22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 23  
BILANCI DHE REZERVAT**

- 23.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë



që Ortaket e shoqerise të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

- 23.2 Ortaket e shoqerise vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 23.3 Ortaket e shoqerise në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

#### **NENI 24 PUNËSIMI NË SHOQËRI**

- 24.1 Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

#### **KREU VIII PRISHJA DHE NJOFTIMET**

#### **NENI 25 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 25.1 Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjera që nuk varen nga Ortaket e shoqerise.
- 25.2 Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaket e shoqerise emërojne një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitit dhe pasivit te Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshëm te përfundimit te tyre. Shoqëria prishet ne këto raste:
  - Kur nuk mund të përbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;



- Me vullnetin e ortakëve;
- Me vendim të Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

**NENI 26**  
**PROCEDURAT QË NDIQEN**

- 26.1 Likuidimi i shoqërisë tregtare "ELFIDA" SHPK vendoset nga Ortaket e shoqerise kur prishet shoqëria.
- 26.2 Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3 Në qoftë se Ortaket e shoqerise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrin vendim ose nuk pranojne të miratojnë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4 Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakeve te shoqerise zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5 Në fund të procesit të likuidimit thirren Ortaket e shoqerise për të vendosur në lidhje me bilancin finanziar përfundimtar.

**NENI 27**  
**NJOFTIMET**

- 27.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në



mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.

- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

**KREU IX  
BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË**

**NENI 28**

- 28.1** Shoqëria “ELFIDA” SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëtin aktivitet.
- 28.2** Gjithashtu shoqëria “ELFIDA” SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4** Transferimi i plotë i aktivit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjeter, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Ortaket e shoqerise.

**KREU X  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 29  
LIGJI I ZBATUESHËM**

- 29.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.



## **“ELFIDA” SHPK -STATUTI**

---

### **NENI 30**

- 30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje originalë secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**ORTAKET E SHOQERIS  
I  
SHOQËRISË “ELFIDA” SHPK**

**Z. Dursun DENIZ**

Dursun Deniz  
